



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°12/2021

Hagë, 02/12/2021

## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme.

Të premtën e shkuar gjykatësit në gjykimin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, refuzuan kërkesat e ekipeve të Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave. Gjithashtu, ditën e hënë gjykatësit refuzuan kërkesën e ekipeve të Mbrojtjes për apelimin e këtij vendimi.

Në fund të konferencës së sotme përgatitore për Mbrojtjen në çështjen gjyqësore Gucati dhe Haradinaj, Trupi Gjyqësor II nxori një numër vendimesh gojore që urdhërojnë, mes tjerash, se paraqitja e provave prej Mbrojtjes do të nis nesër (më 3 dhjetor) me deklaratën hyrëse të Mbrojtjes së z. Gucati dhe do të vazhdojë më 6 dhjetor, me paraqitjen e provave. Paraqitja e provave prej Mbrojtjes së z. Haradinaj do të nis pas mbylljes së paraqitjes së provave prej Mbrojtjes së z. Gucati. Trupi Gjyqësor caktoi 17 janarin 2022 si datë provizore për mbylljen e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.

Si rrjedhojë, konferenca përgatitore e planifikuar për Mbrojtjen do të mbahet sot dhe në rast se nevojitet më shumë kohë do të vazhdojë edhe nesër. Paraqitja e provave prej Mbrojtjes do të fillojë të hënë më 6 dhjetor me deklaratën hyrëse të Mbrojtjes.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ditën e hënë miratoi kërkesën e Mbrojtjes për apelimin e dy aspekteve të vendimit të tij në të cilin kishte rrëzuar kundërshtimet e ngritura nga Mbrojtja për mangësi në formën e Aktakuzës. Sot, Kryetarja caktoi panelin e Gjykatës së Apelit të përbërë prej gjykatësve Mishelë Pikar, Emilio Gati dhe Nina Jorgensen.

1





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°12/2021

Hagë, 02/12/2021

Po në të njëjtën ditë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një vendim tjetër ku refuzonte kërkesën e Mbrojtjes për apelimin e “Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara”.

Në çështjen *Hashim Thaçi dhe të tjerë*, Mbrojtja dhe Prokurori i Specializuar dorëzuan parashtrime lidhur me vazhdimin e paraburgimit të disa prej të akuzuarve. Pasi Gjykatësi i Procedurës Paraprake të nxjerrë një vendim publik lidhur me këtë aspekt, vendimi do të mund të lexohet në faqen zyrtare të internetit të DHS-së.

Seanca e ardhshme në çështjen gjyqësore të Salih Mustafës do të mbahet më 13 dhjetor 2021 në orën 09:30. Dëshmitari tjetër i thirrur nga Prokurori i Specializuar është planifikuar të dëshmojë mes datave 13 dhe 15 dhjetor. Dëshmitari do të dëshmojë me masa mbrojtëse, ku përfshihet ndryshimi i zërit dhe fytyrës si dhe përdorimi i një pseudonimi. Ky do të jetë dhe dëshmitari i fundit që dëshmon për këtë vit. Çështja gjyqësore do të rifillojë vitin tjetër.

**Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

